



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 16.09.2024 në Lipjan ndërmjet

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson drejtori i prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit **Fatos Publica B.I., Rr. Kadri Beba, 14000, Lipjan** i përfaqësuar nga Fatos Publica (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi. Titulli i kontratës: **Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan** me numër identifikues 613-24-9457-5-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan të gjitha të specifikuara të përshkrimi i çmimeve**

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PROJEKTI: RREGULLIMI I KULMIT TË ASHENSORIT NË QKMF

LOKACIONI: LIPJAN

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL LIPJAN

VËREJTJE:

Gjatë realizimit të pozicioneve të kësaj paramase duhet referuar edhe: Përshkrimi Teknik, Projekti, Detajet, Skemat grafike dhe Specifikimet Teknike. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punën, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale (të kompletuar), garancinë, prezentimin e certifikatave për produktet dhe certifikatave të prodhuesve me standarde ISO ose standarde të cilat janë të cekura në përshkrim teknik apo paramase si dhe të prodhohen në përputhje me EC-standartet. Çmimi duhet të përfshijë gjithashtu të gjitha materialet shpenzuese deri në vuarjen në punë. Llogaritja e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të pozicioneve. Të dhënat teknike, dimensionet, sasi të, etj, nëpërmjet kësaj kontrate duhet të jenë me ISU - Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (International System of Units). Të gjitha produktet e propozuara duhet të shoqërohen me një certifikatë cilësie të prodhuesit dhe të miratuar paraprakisht nga mbikëqyrësi. Në rast mospërputhjeje midis të dhënave në paramase dhe Përshkrimi Teknik, ku përshkrimi teknik gjithmonë duhet të merret i pari, duke përjashtuar rastet e gabimeve teknike eventuale ku metoda më e favorshme është se duhet miratuar zgjidhja. Nëse për shkak të neglizhencës në punë shkaktohet dëmtim në zonën përreth kantiertit dhe brenda kantiertit, atëherë përgjegjësi për rregullimin i takon kontraktorit. Materiali i demoluar, mbeturina, dheu etj që nuk ka ndonjë vlerë konsiderohet pronë e pronarit dhe pronari do të japë udhëzime për asgjësimin apo deponimin e materialit të demoluar, ndërsa demolimi dhe transporti janë përgjegjësi e kontraktorit. Çmimi për skeleri duhet të përfshihet në çdo pozicion ku nevojiten për përfundimin e punimeve apo realizimin e atij pozicioni. Çmimet duhet të përfshijnë çdo aktivitet tjetër që nuk përshkruhet këtu, por që është i nevojshëm për përfundimin e punimeve apo realizimin

e pozicionit. Kontraktori është i detyruar të bëjë matjet e të gjitha pozicioneve, para fillimit të prodhimit dhe furnizimit. Për çdo ndryshim të projektit gjatë realizimit apo ndryshim të materialit paraprakisht duhet të merret aprovimi nga projektuesi.

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	komplet	1	100.00 €	100.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit,, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	50.00 €	50.00 €
1.01.03	Pastrimi i tërësishëm i objektit dhe terrenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethoja, etj.	komplet	1	50.00 €	50.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.01	200.00 €

1.02 RENOVIMI I KULMIT NE QKMF LIPJAN					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL

1.02.01	Te behet demolimi i kulmit ekzistues nga llamarina, duke perfshire edhe lamarinat anesore si dhe transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 15 km distance.	m ²	15.0	10.00 €	150.00 €
1.02.02	Furnizimi dhe punimi i konstruksionit bartës dhe mbulesës së kulmit duke përfshirë, mbajtësit kryesor me dy breza të lartësive të ndryshme, brinjët (mahitë), dyshtemenë e punuar nga panelet OSB, membrana difuzive, mbulesa nga llamarina e rrafshët me lidhje vetklikeuse falco, kapakët e kulmarëve, kapakët e lugjeve dhe gërmuqeve, ulluqet vertikale dhe horizontale, pikoret e mureve. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si llamarina të perforuara, pllaka dhe këndore metalike për lidhjen e trarëve, bulonat ankerues për fiksion në pllakë, gozhda, vida dhe mjetet tjera të nevojshme.				
1.02.03	KONSTRUKSIONI I KULMIT NËNKONSTRUKSIONI Trarë druri me dimensione të plota 10x12 cm për konstruksionin bartës të punuar si mbajtës me trarë horizontal në dy nivele dhe vertikale në distancë aksiale 70 cm. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate. Fiksimi në pllakën e betonit me anker bulona në çdo 140 cm.	m ³	0.49	200.00 €	98.00 €
1.02.04	PANELE OSB 3 t=18 mm Panele me trashësi 18 mm për formimin e dyshtemesë së drurit mbi trarëzat/brinjët e kulmit. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksion në trarët/brinjët e drurit - vidat/gozhdat në distancë adekuate dhe mjetet tjera të nevojshme sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit.	m ²	15.00	7.10 €	106.50 €
1.02.05	Membranë difuzive 3 shtresore Ngjitja e membranës difuzive adekuate për kulm me mbulesë llamarine, rezistente ndaj temperaturave të larta, e ngjitur mbi dyshtemenë nga panelet OSB. Materiali të shtrihet dhe fiksohet në dyshteme sipas udhëzimeve të prodhuesit, ndërsa vazhdimet të realizohen me mbipalim të shtresës mbi shtresë për së paku 10 cm. Vijat e vazhdimeve të mbyllen me shirita vetëngjitës sipas specifikimeve të prodhuesit.	m ²	16.50	2.50 €	41.25 €

	Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit. Në shifrën e dhënë të sipërfaqes për mbulim nuk është marrë në konsideratë mbipalimi i shtresave.				
1.02.06	LLAMARINA MONTUESE "KLIKUESE" Mbulimi i sipërfaqeve të pjerrëta të kulmit me llamarina të profiluara me gjerësi 475 mm (gjerësia mbuluese në varësi të brendit/prodhuesit) me brinjët e ngritura >30 mm për shtangim dhe montim/palim në njëra tjetrën me brezin e perforuar/vrima për vidat për fiksime në dërrasa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksime në dysHEME druri nga OSB panelet - vidat në çdo 30 cm dhe mjetet tjera të nevojshme. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit duke llogaritur se mbulimi do të realizohet me elemente njëcopëshe. Në rast se mbulimi patjetër duhet të realizohet me vazhdime atëherë duhet të ketë mbipalim të elementeve së paku 25 cm dhe radhitje të elementeve sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Tipi i kërkuar i mbulesës mund të zëvendësohet eventalisht me llamarinë të rrafshët me lidhje falco klasike duke përmblusur të gjitha kushtet si për tipin e kërkuar, respektivisht të gjitha fiksime dhe lidhjet të jenë në brendi të mbulesës ndërsa krijimi i lidhjeve falco të bëhet me anë të aparateve të posaçme.	m ²	15.00	16.00 €	240.00 €

1.02.07	PROFİLET "L" NE PERIMETER TE KULMIT Elemente nga llamarina e rrafshët e plastifikuar, të profiluara në formë "L" me gjerësi 25+25 cm për të gjitha anet e kulmit duke bere mbyllje të plotë të hapësirës në mes të dyshemese se mbulesës dhe trajeve anesore deri ne fasaden. Gjerësia e shpalosur e llamarinës 110 cm,punimi i llamarines ne forme te shkronjes "h" ne pjesen perfundimtare per dhenjen e formes se pikorës ne komplet gjatesin. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksım - vidat ose "nitne" mbi çdo brinjë dhe në mes të fushës dhe mjetet tjera të nevojshme.	m'	14.50	6.50 €	94.25 €
1.02.08	Pas perfundimit te te gjitha punimeve te behet pastrimi i punishtes nga mbetjet ndertimore si dhe te behet transporti i mbeturinave ne deponin e caktuar nga komuna deri ne 15 km distance.	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €
TOTAL POZICIONI			1.02	780.00 €	

REKAPITULLIM		
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE	200.00 €
1.02	RENOVIMI I KULMIT NE QKMF LIPJAN	780.00 €
PUNËT NDËRTIMORE		GJITHSEJT 980.00 €

REKAPITULLIM I TË GJITHA FAZAVE		
01	PUNËT NDËRTIMORE	980.00 €
PROJEKTI: RREGULLIMI I KULMIT TË ASHENSORIT NË QKMF		GJITHSEJT 980.00 €

Vërejtje: Të gjitha materialet e përdorura duhet të jenë të klasit të parë, mostrat paraprakisht duhet të aprovohen nga organi mbikqyrës apo nga projektanti. Në të gjitha pozicionet të përfshihet furnizimi me material si dhe montimi i tij. Për çdo ndryshim eventual duhet të konsultohet projektanti.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e punëve shprehur në shifra është **980.00 €**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetnja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bresës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha shërbimeve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancia

7.1 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët e furnizimeve që janë te parapara me kete kontratë.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha

punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së puneve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë materialet dhe shërbimet e kryera, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet janë kryer sipas paramasës në kontratë. Menaxher i kontratës caktohet **Sinan Meziu**.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	Fatos Publica
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.09.2024	Data:	17.09.2024
Vula:		Vula:	

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	613-24-9457-5-4-7	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan	
Numri i brendshëm Internal No Interni broj				

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
13.09.2024	13.09.2024, 14:00:00	13.09.2024,		1

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	Fatos Publica B.I., Rr. Kadri Beba, 14000, Lipjan	613-24-9457-5-4-7	Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan	PO	980.00	980.00	JO

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO


Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Fatlum Breznica		16.09.2024
Bekim Arifi		16.09.2024

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Bekim Shabani



* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

NJOFTIMI PËR NENSHKRIMIN E KONTRATËS

☐ FURNIZIM☒ PUNË☐ SHËRBIME

Sipas Nenit 41A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 17.09.2024

Nr i Prokurimit	613-24-9457-5-4-7
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN		
Adresa Postare: SHQIPERIA		
Qyteti: LIPJAN	Kodi postar: 14000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bekim Shabani		Telefoni: 03820041520
Email: bekim.g.shabani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Po ☐Jo ☐

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)		
☒ Punë	☐ Furnizime	☐ Shërbime
☐ Ekzekutim ☐ Plan i dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjëse me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve / Vendi kryesor i dorëzimit / Vendi kryesor i realizimit
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë: Po ☐ Jo ☒ Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj
II.1.4) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Vlera e parashikuar e kontratës: 995.00
Financuar: ☐ Vetanake ☐ Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ☐ Donacion
Kohëzgjatja e kontratës (data e fillimi dhe përfundimit) Ne dite: Ne muaj: Data e fillimi: Data e përfundimit:
II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45000000-7

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

- ☐ E hapur
- ☐ E kufizuar
- ☐ Konkurruese me negociata
- ☐ E negociuar
- ☐ Kuotim
- ☒ Vlere minimale

III.2) KRITERET E DHËNIES

☒ Çmimi më i ulët <i>ili</i> ☐ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm

NENI IV: DHËNIA E KONTRATËS

(Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit S IV.3, IV.4 dhe IV.5 për secilën pjesë)

IV.1) Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit: 11.09.2024		
Data e publikimit të Njoftimit për kontratë:		
Data e hapjes së tenderëve: 13.09.2024		
Data e publikimit të Njoftimit të dhënies së kontratës:		
Data e nënshkrimit të kontratës: Shih Nenin IV.3)		
IV.2) Numri i kërkesave për tërheqje të Dosjes së Tenderit:		
Numri i tenderëve të pranuar: Shih Nenin IV.3)		
Numri i tenderëve të përgjegjshëm: Shih Nenin IV.3)		
Afati kohor për dorëzim të tenderëve: ☐ normal ☐ i shkurtuar		

IV.3) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, me të cilin është nënshkruar kontrata

Kontrata No.: 613-24-9457-5-4-7/C991
Grupi No.: 1
Grupi: Rregullimi i kulmit të ashensorit në QKMF-Lipjan
Data e nënshkrimit të kontratës: 17.09.2024
Numri i tenderëve të pranuar: 1
Numri i tenderëve të përgjegjshëm: 1

Emri zyrtar: Fatos Publica B.I.

Adresa Postare: Rr. Kadri Beba

Qyteti: Lipjan

Kodi postar: 14000

Vendi: Kosovë

URL (nëse aplikohet):

Personi kontaktues:

Email:

Telefoni: 044689526

Faksi:

IV.4) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës 980.00 EUR

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: 980.00

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: 980.00

IV.5) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktohet

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, vlera e kontratës apo përqindja që ka gjasa të nënkontraktohet

Vlera : ano Përqindia %: Nuk dihet ☐ ☐

--

V) INFORMACIONET SHITESË

--